

DANJA SINANAJ

FJALË “TË PALIGJSHME” NË LIGJËRIMIN JURIDIK

Kjo trajtesë lidhet me një prej nënstileve funksionale të ligjërimit zyrtar, me ligjërimit juridik, në të cilin, ndryshe prej nënsistemeve të tjera të ligjërimit administrativ, fjala a kuptimi i pavend bart pasoja rrezikuese për një shoqëri të shtetit të së drejtës. Ai dallohet qartësisht prej formave të tjera të të shprehurit zyrtar: në leksik, në rendin e brendshëm dhe kodifikimin e rreptë gjuhësor e të mendimit, në përjashtimin e përfshirjes emocionale.

Me këtë punim, jemi përpjekur të gjejmë prerjen e përbashkët të procesit të ligjbërjes me mundësitë e shumëfishta komunikuese që ofron gjuha shqipe, duke e ndarë atë katër pjesë. Në fillim paraqiten kalimthi disa probleme të traditës jo aq të gjatë të nënstilit juridik në gjuhën shqipe me problemet e veta. Më tej bëhen të njohura disa parime të pranuara e të kthyer në traditë në të drejtën eurokomunitare lidhur me standardin gjuhësor në teknikën legjislative. Në pjesën e tretë identifikohen problemet më të mprehta të bërjes së ligjeve sot në Shqipëri, duke veçuar fjalët dhe kuptimet e paligjshme në këtë stil dhe së fundmi bëhet një përpjekje për një sintezë problematike të gjendjes gjuhësore-juridike në vend.

Fjalë kyçe: teknikë legjislative, gjuhë shqipe, fjalë, keqpërdorim, devijim, keqinterpretim, hartim legjislacioni, fjalor.

I.

Duke qenë se tradita ligjëvënëse në shtetin shqiptar është afërsisht një shekull, stili juridik i ligjërimit paraqet probleme serioze të ndërprerjes së vazhdimësisë terminologjike dhe të inkoherencës. Në periudhën mbretërore kodet themelore u përshtatën prej së drejtës franceze, zvicerane e italiane, dhe bashkë me to hynë me shumicë terma prej frëngjishtes, për të vijuar më vonë me ndikime të forta të terminologjisë së të drejtës italiane.

Në periudhën e pasluftës veprimtaria ligjëvënëse u reduktua tej mase dhe një fjalor minimal termash të së drejtës ishte i mjaftueshëm. Ndërsa në dy dekadat e fundme pati një vërshim të terminologjisë prej së drejtës britanike, më saktë prej anglishtes, duke çuar deri në rimbushjen kuptimore të mjaft termave të trashëguar më parë: *aplikim* e humbi kuptimin e fjalës shqipe *zbatim* dhe u përdor për *paraqes një kërkesë*; në vend të kësaj fjale hyri termi *implementim*; *informale* kishte kuptimin e *fshehtë* dhe fitoi kuptimin *jozyrtare*.

Kodifikimi i stilit juridik të ligjërimit është një proces në vijimësi¹. Ky proces ka probleme të mirëfillta gjuhësore, probleme të teknikës së hartimit të ligjeve, probleme të vetëdijes dhe formimit ligjor të ligjvënësve, duke mos përjashtuar dhe probleme të përdorimit të qëllimshëm të gjuhës për të krijuar hapësira ligjore të nënkuptuara. Një fjalor standardizues i përditësuar i termave të së drejtës sot, që do të lehtësonte procesin e njësimimit të stilit juridik të komunikimit, do të ishte shumë funksional për ligjbërjen dhe zbatueshmërinë e ligjit. Mungesa e një *lexicon*-i të tillë, të përshtatshëm për një shoqëri të hapur konkurrence, provohet edhe në faktin e njohur gjerësisht, që thuajse të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore që hartohen hapen me kreun e përkufizimeve dhe termave, të përcaktimit të kontekstit të tyre dhe kuptimin konvencional që kanë². Në fakt, përkufizimet përcaktojnë kuptimin e termave kryesorë të përdorur në tekst dhe për çdo përkufizim duhet përcaktuar një kuptim i vetëm. Lejimi i shumëkuptimisë së gjuhësore një nocioni juridikisht përkufizues, siç ndodh shpesh e rëndom, e le të hapur tekstin për interpretime situative, për të mos thënë dhe abuzive.

Problemet më të ndërlikuara të paligjshmërisë së fjalës në ligjërimit juridik paraqiten në aktet nënligjore, ku papërcaktueshmëria, evaziviteti e paqartësia mund të shprehin dhe një vullnet të fshehur për subjektivitet të pashpallur në zbatimin e akteve. Është një shenjë për t'u çmuar premtimi për rikthimin e autoritetit të redaktorit gjuhësor në procesin e certifikimit të korrespondencës burokratike të shtetit, por kjo më urgjente se kudo është në procesin legjislativ, ku juristi nuk bën dot pa gjuhëtarin, nëse dëshiron që fjala të mos bëjë faj.

II.

Në përvojën juridike-gjuhësore europiane theksohet se qëllimi kryesor i një hartuesi ligji duhet të jetë parimisht thjeshtësia dhe lehtësia e të kuptuarit të asaj çka parashikon një tekst ligjor³. Pra, e shprehur ndryshe, një ligj duhet të prezantojë qartë çfarë na lejohet dhe çfarë na ndalohet, me një gjuhë të qartë, të saktë dhe të thjeshtë. Hartimi i fjalive, i dispozitave në vetvete duhet të ndjekë rregullat e përgjithshme gramatikore, me qëllim kumtimin e diçkaje.

Sipas një vendimi të Këshillit Kushtetues Francez të vitit 1999, ligji duhet të jetë lirisht i aksesueshëm dhe i kuptueshëm për të gjithë qytetarët, dhe ky është objektiv me vlera kushtetuese. Barazia përpara ligjit dhe garancia e

¹ R. Pagano, *Aperçu de la rédaction des lois, Intervention au cours de Pratique du Droit de l'Institut International de Droit du Développement*, Rome, 23 tetor 2002, f. 11.

² A. F. Bisson, *L'interaction des techniques de rédaction et des techniques d'interprétation des lois*, në: *Les Cahiers de droit*, vol. 21, nr. 3-4, 1980, f. 511-522.

³ Rédiger la Loi, *Guide de rédaction des propositions de loi et des amendements*, Édition Septembre 2007, f. 28.

mbrojtjes të së drejtave qytetare nuk mund të jenë efektive, në rast se qytetarët nuk janë njohur në mënyrë të mjaftueshme me normat, të cilat iu aplikohen dhe nëse vetë normat nuk janë hartuar për një interpretim univok. Njëkohësisht fjalitë normative u nënshtrohen edhe rregullave të tjera të veçanta. Mbi të gjitha, fjalia normative duhet të jetë e shkurtër dhe e qartë, duke evituar sa më shumë që është e mundur fjalinë e përbërë. Idealja do të ishte që fjalia të ndërtohej thjesht me kryefjalë, folje dhe një pjesë plotësuese, një ndërtim gramatikor sa më i kursyer. Në këtë kuptim, rreptësia dhe minimalizmi që kërkon nënstili juridik, nuk pajtohen me bujarinë e gjuhës në përgjithësi, me elasticitetin, kuptimet modale, duke mos përjashtuar ekuivokun.

Një prej detyrimeve që ka lindur për shtetin shqiptar gjatë dekadës së fundme lidhet me përkthimin e legjisllacionit kombëtar në gjuhën angleze, që është pjesë e eurokodifikimit të tij. Mund të imagjinohet lehtësisht vështirësia që del për përkthyesin në rastin kur një tekst ligjor përmban dispozita të gjata, me shumë pjesë bashkërenditëse e nënrenditëse. Kësaj i shtohet problemi tjetër: sa i komplikuar do të ishte për lexuesin e huaj leximi juridik i tekstit⁴.

Një dispozitë, qoftë ajo e një ligji, apo akti nënligjor, duhet të hartohet në kohën e tashme. Madje, edhe në rastet kur dispozita parashikon një detyrim të ri ligjor, një strukturë të re administrative, apo një bashkëpunim të ardhshëm ndërinstitucional, të cilët nuk ekzistojnë deri në hyrjen në fuqi të asaj dispozite, stili juridik nuk lejon të përdorur ajo e ardhme që mund të kuptohet si e ardhme detyruese. E ardhmja ka lejim të përdoret vetëm në rastin kur dispozita parashikon një eveniment, apo një datë që do të ndodhë një herë të vetme, pra, jo një standard, por një situatë ligjore⁵. Për faktet që ndodhin në të njëjtën kohë me veprimin e ligjit, njësoj si në stile të tjera apo në gjuhë mbarë, përdoret folja në kohën e tashme, ndërsa për faktet që paraprijnë veprimin e ligjit folja duhet të jenë në kohën e shkuar⁶.

Edhe fjalë që gjuhëtarët i njohin si shërbyese, si pjesëzat mohuese, në stilin juridik kanë regjim tjetër, nuk mund të përdoren në fjalinë normative, sepse ligji parashikon detyrimin dhe jo ndalimin. Pra, të gjithë këta elementë duhet të merren parimisht dhe praktikisht parasysh gjatë hartimit të një ligji të ri. Në kushtet kur këto aspekte të teknikës legjisllative nuk vihen në zbatim,

⁴ M. Sparer, W. Schwab, *Rédaction des lois: rendez-vous du droit et de la culture*, deuxième partie, Les instruments, du message, Chapitre Premier, L'article: ses dimensions et son contenu, ses multiples et sous-multiples, Québec.

⁵ Rédiger la Loi, *Guide de rédaction des propositions de loi et des amendements*, Édition Septembre 2007, f. 39.

⁶ *Manual i hartimit të ligjeve, Një udhërrëfyes për procesin legjisllativ në Shqipëri, Teknika e hartimit të ligjeve*, Tiranë, 2010, f. 111.

gjejmë forma të çuditshme shprehjeje, që lejojnë hapësira interpretimi, ose ndryshojnë edhe kontekstin e vërtetë të asaj çka dëshirojmë të shprehim.

Së fundi, një problem që mund të hasim gjatë punës me teknikën legjislativë lidhet me sinoniminë juridike. Ashtu sikurse është i rekomandueshëm mospërdorimi i të njëjtit term për të përcaktuar dy gjëra të ndryshme, po ashtu hartuesi i ligjit duhet të ruhet nga përdorimi i shumë termave për të përkufizuar të njëjtën gjë. Përsëritja stilistikisht në gjuhë mund të shkaktojë monotoni e varfëri, por në stilin juridik nuk është aspak për t'u shqetësuar fakti se shumë terma do të përsëriten shpesh në tekst, sepse objektivi nuk është shkrimi i një vepre letrare, por e një norme juridike.

III.

Kjo trajtesë, ka tentuar të shqyrtojë gjithashtu raportet midis gjuhës si mundësi shprehjeje dhe ligjit si njësuës i veprimi juridik. Në aspektin gjuhësor, si njohës vullnetmirë të mundësive shprehëse që ofron gjuha, pa pretenduar kompetencat dhe aftësitë e gjuhëtarëve të vërtetë, jemi munduar të shpjegojmë disa prej rreziqeve që sjell gjuha në ligjërimin juridik.

Në vështrim parësor do të jenë fjalët polisemantike, fjalët emërtuese ose treguese me kuptim të pacaktuar, fjalët shumëkuptimëshe ose me kuptime kundërtë, fjalët semantikisht evazive, fjalët kontekstualisht të rimbushura semantikisht, fjalëformimet e ardhura prej stilit juridik, kalket gjuhësorë etj.

Fjalët polisemantike janë sigurisht të bukura dhe të këndshme për t'u përdorur në gjuhë dhe letërsi, por në ligjërimin juridik ato konsiderohen të rrezikshme. Përdorimi i këtyre fjalëve në stilin juridik mund të kryhet qëllimisht, ose mund të përdoren për shkak të mungesës së kulturës juridike, të njohurive themelore të teknikës legjislativë dhe të metodologjisë juridike të punës të hartuesve të ligjit. Në çfarëdoqë rasti, polisemia për një jurist shkakton probleme interpretimi, duke qenë se prania e disa kuptimeve, të njëjtës fjalë, brenda kontekstit ligjor, mjegullon hapësirën e ligjit, u jep më tepër mundësi për abuzim subjekteve që i nënshtrohen këtij teksti dhe rrjedhimisht liberalizon vendimmarrjen, standardi mundëson voluntarizmin.

Gjithashtu, një grup tjetër fjalësh që shkaktojnë vështirësi në kuptim dhe zbatim lidhet me fjalët me kuptim të papërcaktuar edhe në ligjërimin e thjeshtë gjuhësor. Në këtë rast nuk gjejmë përplasje midis dy ligjërimeve, megjithatë përballemi me disakuptimësi, shpesh herë edhe për shkak të cektësisë së përpiluesve të teksteve ligjore. Ndër rastet që mund të përmendim, lidhen me përemrat dëftorë dhe të pakufishëm, si dhe mbiemrat e formuar prej tyre. Kudo që gjejmë një përemër, arrijmë shpejt në konkluzionin se teksti është i komprometuar. Fjalëve të tilla, duke mos pasur një kuptim të drejtpërdrejtë, thelbin duhet t'ua kërkojë duke i kontekstualizuar rast pas rasti.

Emrat në gjuhën shqipe janë të ndarë në dy gjini, por gjatë hartimit të ligjeve, përpiluesi duhet të prezantojë normën ligjore në mënyrë sa më

neutrale, sido që kjo mund të ngjajë si diskriminim gjuhësor për femrat. Prandaj përgjithësisht përdoret fjala *person*, në vend të përemrave *ai/ajo*, që është pranuar në mënyrë të heshtur se i përfshin të dyja gjinitë. Alternativa të tjera në përdorim, inkurajuar pikërisht prej asaj që mund të quhet barazi gjuhësore ndërgjinore, janë edhe përdorimi i të dyja gjinive si p.sh.: *drejtori/drejtoresha*, apo përdorimi i dy përemrave vetorë *ai/ajo*. Nga praktika e zakonshme konstatohet se një përdorim i tillë është i vështirë dhe i lodhshëm për t’u lexuar.

Ndër fjalët e tjera të paligjshme, mund të përmendim leksemat me kuptim shtues dhe perifrazat, ku si më të rrezikshmet mund të përmendim *e të tjerë, si më sipër, si më poshtë, të ngjashme me to ose si këto, raste analoge, rrethana të tilla si*. Nëse marrim si shembull paligjshmërinë e një prej këtyre fjalëve me kuptim shtues a shkufizues, për shembull *të tilla si*, një dispozitë që përdor këtë term duhet të interpretohet sikur lë jashtë aspekte të tjerë në mënyrë përjashtimore dhe detyrimisht shkakton paqartësi ligjore⁷. Në këto kushte, legjislatori e braktis detyrën e tij për të përcaktuar qartë perimetritin real të aplikimit të ligjit dhe e transferon qëllimisht barrën e interpretimit tek gjykatësi, në rastin e një konflikti gjyqësor⁸. Mirëpo, askush nuk mund të sigurojë se gjykatësi do të dijë ta aplikojë ligjin ashtu siç duhet, kur vetë ligji ka deficiencën e dukshme. Nga ana tjetër, askush nuk mund ta paragjykojë gjykatësin për vendimin që do të marrë, duke qenë se margjina e interpretimit është e madhe.

Si shembull konkret në legjislacionin shqiptar mund të përmendim Ligjin nr. 152/2013 *Për nëpunësin civil*, neni 17, paragrafi 2, i cili përcakton se:

“Departamenti i Administratës Publike krijon dhe administron Regjistrin Qendror të Personelit, që është një bazë unike shtetërore të dhënash, që përfshin të dhënat profesionale dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo të punësuarit në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore”.

Theksojmë se në këtë ligj, fjalët *e tjera*, *të tjera* janë përdorur rreth njëzet herë. Dhe nuk është fjala për raste të tilla kur këto përemra të pakufishëm janë në funksionin e duhur nëse përdoren për të mos lejuar kuptime të dyfishta, apo kuptime evazive. Konkretisht, një rast ligjshmërie i kësaj fjale gjendet në nenin 50, paragrafi 4, ku parashikohet se:

“Nëpunësi mund ta refuzojë transferimin në rastin e mbylljes dhe rishikimit të institucionit vetëm për arsye të parashikuara në dispozitën e

⁷ *Manual i hartimit të ligjeve, Një udhërrëfyes për procesin legjislativ në Shqipëri, Teknika e hartimit të ligjeve*, Tiranë, 2010, f. 105.

⁸ *Rédiger la Loi, Guide de rédaction des propositions de loi et des amendements*, Édition Septembre 2007, f. 41.

këtij neni, prandaj refuzimi i transferimit për arsye të tjera përbën shkak për lirin nga shërbimi civil”.

Nga kjo kuptojmë qartazi se arsyet e refuzimit të transferimit të një punonjësi civil përbëjnë një listë shteruese, jashtë së cilës nuk mund të parashikohen raste të tjerë.

Për më tepër, në tekstet ligjore gjejmë shpesh fjalë që janë formuar dhe kanë ardhur prej ligjërimit juridik, pa pasur ende një standard të përcaktuar në fjalorët e gjuhës shqipe. Një prej shembujve që përdoret rregullisht në të stilin juridik është folja *ankim*, që ka marrë përdorim të gjerë dhe ka zëvendësuar në mënyrë të konsiderueshme foljen *apeloj*. Ka edhe raste të tjerë kur një fjalë ka një kuptim të caktuar në ligjërimitin tradicional dhe një kuptim tjetër në ligjërimitin juridik, duke u vënë kështu përballë fjalësh me rimbushje semantike.

Një kategori e veçantë fjalësh lidhet me kalket dhe me huazimet e fjalëve nga gjuhë të huaja. Huazimi i një pjese të termave juridikë ka ardhur edhe si pasojë e përafrimit të legjislacionit shqiptar me traditën ligjore europiane, drejt eurokodifikimit të rendit të brendshëm juridik. Në kushte të tilla, nuk janë marrë vetëm terma, por janë përdorur tekste të plota ligjore, të cilët janë përkthyer dhe transpozuar, duke sjellë fenomenin e transplantit ligjor e gjuhësor, i cili ndër efektet negative që sjell, merr me vete modele të gatshme ligjesh që sjellin huazime të paprovuara më parë në gjuhë e që përdoren drejtpërsëdrejti në drejtësi.

Kështu, mund të na lindë natyrshëm pyetja nëse termi *privatësi* i korrespondon fjalës *privacy*. Sigurisht që, mund të jetë formuar sipas një logjike gjuhësore, por nëse e marrim përkufizimin e fjalës *privacy* në të drejtën eurokomunitare, konstatojmë që kemi të bëjmë me jetën intime të njeriut, ndërkohë që koncepti i kalkuar i kësaj fjale në *privatësi* ka një shtrirje më të gjerë se kuptimi në anglisht.

Në pikëvështrimin e ligjbërjes, fjalët e huaja duhet të shmangen në përpilimin e një teksti ligjor, nëse ekziston një term ekuivalent në gjuhën shqipe. Në rast të kundërt, përdorimi i tyre duhet të jetë pranuar në përdorimin e përditshëm të gjuhës shqipe dhe njëkohësisht ekzistenca e këtyre fjalëve nuk është e mundur në gjuhën tonë⁹. Kriteri i përdorimit të një fjale të huaj lidhet me mosekzistencën në shqip dhe me përdorimin e fjalës së huaj në ligjërimitin gojor, mjafton që masës t’i jetë vlarë veshi me përdorimin e saj. Fjalët më të shpeshta në përdorim janë: akordo (jap pëlqimin, pajtohem), akses (hyrje), aktuale (e tanishme), asistencë (ndihmë), azhurnim (përditësim), destinacion (vendmbërritje), eksperiencë (përvojë), evidentoj (nxjerr në pah).

⁹ Manual i hartimit të ligjeve, Një udhërrëfyes për procesin legjislativ në Shqipëri, Teknika e hartimit të ligjeve, Tiranë, 2010, f. 107.

Një kategori *shartimesh* të stilit juridik me mjete stilistike ekstrajuridike lidhet me dëshirën e ligjvënësit për të konfirmuar situatën e vet, me përfshirjen emocionale brenda përmbajtjes së ligjit, me atë që mund të quhet *ligjshmëri patriotike*, për të cilën gjuha nuk është as shkas, as burim, por thjesht mjet shprehjeje në një mënyrë jojuridike prej hartuesve dhe miratuesve të ligjit. Kur ligjvënësi, në Ligjin nr. 9280, datë 23.09.2004, *Për shpalljen e Ditës së Kujtesës*, neni 2 paragrafi 2, shprehet se: “*Dita e Kujtesës*“ është ditë e nderimit të të gjithë atyre që kanë ndihmuar për mbrojtjen fizike të hebrenjve që jetonin dhe që erdhën në Shqipëri para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore **dhe gjetën shpëtim në tërësi**“, theksimi i fundmë thjesht shpreh një vullnet konfirmues të një realiteti historik, që nuk ka të bëjë me ligjin vetë.

IV.

Stili juridik i ligjërimit në shqip është një stil në formim e sipër, me disa shmangie në traditën e vet prej më pak se një shekulli dhe me disa shtresëzime terminologjike të burimeve të huaja e vendëse, shpesh mospajtuere mes tyre.

Disa shprehje të papërkufizuara në ligj vijnë jo për shkak të pamjaftueshmërisë shprehëse të gjuhës, por për shkak të dukurive institucionale të periudhës kalimtare.

Shprehje të paskajuara në ligje gjenden për arsye subjektive: ky fenomen shkaktohet mbi të gjitha për mbrojtjen e interesave institucionale, për krijimin e një favorizimi të arsyes shtetërore. Megjithatë, nuk duhet të harrojmë se ka edhe raste kur ky subjektivitet kthehet në praktikë dhe bëhet i nevojshëm, si në rastet kur përdoren fjalët si: “afat i arsyeshëm”, “mirëbesim”, “mbrojtje legjitime”, “masë proporcionale”, “rrethana lehtësuese” etj. Edhe në këtë rast barra interpretuese i transferohet dhe i përket gjykatësit¹⁰.

Paqartësia e karakterit gjuhësor lidhet me kalkimin ose rikuptimësimin e termave prej burimesh të huaja, që shprehin inkompetencë gjuhësore dhe juridike njëherësh¹¹. Megjithatë, në emër të përshtatjes së legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Europian, të njohur si *acquis communautaire*, është toleruar përdorimi i disa fjalëve, të cilat edhe nëse e kanë një përdorim në gjuhën shqipe, janë përdorur në gjuhën e origjinës (kryesisht në gjuhën angleze dhe frënge, si dy gjuhë zyrtare të instancave më të larta të Bashkimit Europian).

Nga ana tjetër, nëse do të hartohet një *Lexicon* i termave të ligjeve dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tyre dhe të krahasohet ky *Lexicon* me fjalët që përmban fjalori i gjuhës shqipe, do të ishte interesant përfundimi, sepse

¹⁰ *Rédiger la Loi, Guide de rédaction des propositions de loi et des amendements*, Édition Septembre 2007, f. 42.

¹¹ *Guide de rédaction des lois et amendements, Structure d'un texte, Usages de la langue, Techniques de rédaction, Cas pratique*, Assemblée nationale, juillet 2007.

termat ligjorë nuk përkojnë me termat gjuhësorë në fjalor, pra, kanë kuptime të ndryshme, ose akoma më keq, ato nuk ekzistojnë fare në të. Pjesërisht kjo mund të shpjegohet me dinamizmin e jetës administrative dhe me një ngadalësi konservative që ka gjuha vetë, por faktori më pengues është muri që ekziston ende midis ligjvënësve dhe gjuhëtarëve.

BIBLIOGRAFI

- A. F. Bisson, *L'interaction des techniques de rédaction et des techniques d'interprétation des lois*, në: Les Cahiers de droit, vol. 21, nr. 3-4, 1980.
- Guide de rédaction des lois et amendements, Structure d'un texte, Usages de la langue, Techniques de rédaction, Cas pratique*, Assemblée nationale, juillet 2007.
- Guide pour la rédaction des textes législatifs*, Assemblée nationale, mars 2011.
- Ligji nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil".
- Ligji nr. 9280, datë 23.09.2004, "Për shpalljen e Ditës së Kujtesës".
- M. Sparer, W. Shwab, *Rédaction des lois: rendez-vous du droit et de la culture, deuxième partie, Les instruments, du message, Chapitre Premier, L'article: ses dimensions et son contenu, ses multiples et sous-multiples*, Québec.
- Manual i hartimit të ligjeve, Një udhërrëfyes për procesin legjislativ në Shqipëri, Teknika e hartimit të ligjeve*, Tiranë, 2010.
- R. Pagano, *Aperçu de la rédaction des lois, Intervention au cours de Pratique du Droit de l'Institut International de Droit du Développement*, Rome, 23 tetor 2002.
- Rédiger la Loi, *Guide de rédaction des propositions de loi et des amendements*, Édition Septembre 2007.